



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1063/1 Prot.

Tiranë, më 07-04 2023

VENDIM

Nr. 45 dt. 07.04 .2023

“PËR MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË FORMIMIT TË VAZHDUAR NË FUSHËN PSIKO-PEDAGOGJIKE NË EDUKIMIN FIZIK, SPORT DHE SHËNDET NË FSHL”

Në zbatim të nenit 3 pika 2 gërma b, nenit 38 pika 1 gërma dh, nenit 81 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, kreun II pika 3 të Udhëzimit të MAS nr.3, datë 15.02.2023 “Për përcaktimin e diplomave universitare të njëvlershme, të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në Arsimin Parauniversitar dhe kriteret për hapjen e e programeve të studimeve të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike” nenit 20 (gërma f) të Statutit të UST-së, nenit 7 të Rregullores së Universitetit të Sporteve të Tiranës, Vendimit të Rektoratit nr.34 datë 05.04.2023 “Për miratimin e dokumentacionit të hapjes së programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike në Edukimin Fizik, Sport dhe Shëndet në FSHL” (bashkëlidhur); Senati Akademik i Universitetit të Sporteve të Tiranës, në mbledhjen e datës 07.04.2023,

V E N D O S I :

1. Të miratojë hapjen e programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike në “Edukimin Fizik, Sport dhe Shëndet”, në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes, të UST-së, sipas dokumentacionit bashkëngjitur.
2. Ky vendim t’i dërgohet për miratim Bordit të Administrimit.
3. Ngarkohet Drejtorja e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akdemiko-Shkencore për publikimin e këtij Vendimi.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. AGRON KASA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORATI

Nr. 1037 Prot.

Tiranë, më 05.04 2023

V E N D I M

Nr. 34 dt. 05.04 2023

“PËR
MIRATIMIN E DOKUMENTACIONIT TË HAPJES SË PROGRAMIT
TË STUDIMIT TË FORMIMIT TË VAZHDUAR
NË FUSHËN PSIKO-PEDAGOGJIKE NË EDUKIMIN FIZIK, SPORT DHE SHËNDET
NË FSHL”

Në zbatim të nenit 3 pika 2 gërma b, nenit 40, nenit 81 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, kreun II pika 3 të Udhëzimit të MAS nr.3, datë 15.02.2023 “Për përcaktimin e diplomave universitare të njëvlershme, të ngjashme ose të përafërta me fushën/ lëndët e mësimdhënies në Arsimin Parauniversitar dhe kriteret për hapjen e e programeve të studimeve të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike” nenit 25 të Statutit të UST-së, nenit 11 të Rregullores së Universitetit të Sporteve të Tiranës, si dhe në shkresën e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes nr. 849/5 Prot., datë 31.03.2023 “Përcjellje për miratim e dokumentacionit të ardhur nga Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit për hapjen e “Programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën Psiko-Pedagogjike” në Edukimin Fizik, Sport dhe Shëndet në FSHL”, Rektorati i Universitetit të Sporteve të Tiranës, Rektorati në mbledhjen e datës 05.04.2023,

V E N D O S I :

1. Miratimin e dokumentacionit të hapjes së programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike në edukimin fizik, sport dhe shëndet, në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes, të UST-së, si vijon:
 - Rregullore e programit të studimit;
 - Plan Mësimor;
 - Model i çertifikatës dhe listës së notave;
 - Lista emërore e personelit akademik që do të përfshihet në programin e studimit.
2. Ky vendim t’i përcillet për miratim Senatit Akademik të UST-së.

REKTORI

Prof. Dr. AGRON KASA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES
DEKANATI

Nr. 849/4 Prot.

Tiranë, më 31.03 2023

Lënda: Përcjellje për miratim e dokumentacionit të ardhur nga Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit për hapjen e "Programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën Psiko-Pedagogjike" në "Edukimin Fizik, Sport dhe Shëndet" në FSHL

KRYETARIT TË SENATIT TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS
PROF.DR. AGRON KASA

Mbështetur në propozimin e ardhur me shkresën nr. 849/4 prot, dt. 29.03.2023 (bashkëngjitur) nga Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit, në pikën 1,2,3 të nenit 81 "Programet e studimeve të vazhduar" të Ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", në Udhëzimin e MAS me Nr. 3, datë 15.02.2023, Kreu II, pika 3 "Për përcaktimin e diplomave universitare të njëvlershme, të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në Arsimin Parauniversitar dhe kriteret për hapjen e programeve të studimeve të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike", kërkojmë të miratoni në Senatin Akademik e më pas në Bordin e Administrimit, dokumentacionin për hapjen e "Programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën Psiko-Pedagogjike" në "Edukimin Fizik, Sport dhe Shëndet" në FSHL si më poshtë:

1. Rregulloren e programit të studimit;
2. Planin Mësimor;
3. Modelin e certifikatës dhe listën e notave;
4. Listën emërore të personelit akademik që do të përfshihet në programin e studimit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

Prof.Dr. Dhimitraq PRIETI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
FAKULTETI I SHKENÇAVE TË LËVIZJES
DEPARTAMENTI I EDUKIMIT DHE SHËNDETTIT

Nr. 849/19 Prot.

Tiranë, më 29.10.2023

Lënda: Përcjellje për miratim të dokumentacionit për hapjen e programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën Psiko-Pedagogjike në "Edukim Fizik, Sport dhe Shëndet" në FSHL.

**DEKANIT TË FAKULTETIT TË SHKENÇAVE TË LËVIZJES
PROF.DR.DHIMITRAQ PRIFTI**

Mbështetur në Vendimin e Dekanatit të FSHL nr.7, datë 20.03.2023 për "Miratimin e grupit të punës për hapjen e programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën Psiko-Pedagogjike në "Edukim Fizik, Sport dhe Shëndet" si dhe në Udhëzimin Nr.3, datë 15.02.2023, për "Përcaktimin e diplomave universitare të njëvlershme, të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në Arsimin Parauniversitar dhe kriteret për hapjen e programeve të studimeve të formimit të vazhduar në fushën Psiko-Pedagogjike", Kreu II, pika 3, po ju përcjellim bashkangjitur për miratim në Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit dokumentacionin si më poshtë vijon:

1. Rregulloren e programit të studimit
2. Planin mësimor
3. Modelin e certifikatës dhe listës së notave
4. Listën emërore të personelit akademik që do të përfshihet në programin e studimit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PËRGJEGJËS DEPARTAMENTI

Dr. Keida USHTELENCIA



UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES
DEPARTAMENTI I EDUKIMIT DHE SHËNDETIT

**“RREGULLORE E
PROGRAMIT TË STUDIMIT TË FORMIMIT TË
VAZHDUAR NË FUSHËN
PSIKO-PEDAGOGJIKE PËR USHTRIMIN E
PROFESIONIT TË RREGULLUAR TË MËSUESIT,
NË EDUKIM FIZIK, SPORT DHE SHËNDET”**

Tiranë, 2023

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Baza ligjore

Rregullorja e Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike, në vijim “Rregullorja”, për Ushtrimin e Profesionit të Rregulluar të Mësuesit, mbështetet në:

- 1.1. Ligji Nr. 80 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 81 i këtij ligji në pikat 1, 2, 3 që lejon institucionet e arsimit të lartë për të zhvilluar programe të formimit të vazhduar.
- 1.2. Udhëzimin Nr. 3, datë 15.02.2023 i MAS “Për Përcaktimin e Diplomave Universitare të Njëvlershme, të Ngjashme ose të Përafërta me Fushën/Lëndët e Mësimdhënies në Arsimin Parauniversitar dhe Kriteret për Hapjen e Programeve të Studimeve të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike”
- 1.3. Statutin dhe Rregulloren e brendëshme të Univesitetit të Sporteve të Tiranës, në vijim “UST”.

Neni 2

Objekti i Rregullores

Rregullorja, ka si objekt:

- 2.1. Vendosjen e rregullave të organizimit dhe realizimit të “Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike për Ushtrimin e Profesionit të Rregulluar të Mësuesit”.
- 2.2. Përcaktimin dhe rregullimin e marrëdhënieve që krijohen ndërmjet ofruesit të programit dhe përfituesit/ve.
- 2.3. Përcaktimin e të drejtve dhe detyrimet e subjekteve;
- 2.4. Përcaktimin e rregullave; për pranimin e studentëve, për mësimdhënien, për vlerësimin dhe për certifikimin e studentëve/përfituesve.

Neni 3

Përmbajtja e Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike në “Edukim Fizik, Shëndet dhe Sport”

Plani mësimor përmban 6 module/lëndë të formimit psiko-pedagogjik, nga të cilat 5 module/lëndë bazë, dhe 1 modul /lëndë opsionale me zgjedhje nga module sipas specifikave të seciles IAL si dhe provimin përfundimtar.

Qëllimi i përgjithshëm i programit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike në “Edukim Fizik, Shëndet dhe Sport” është që studentët të fitojnë një sfond të gjerë dhe të qëndrueshëm shkencor, si dhe kompetenca që lidhen me formimin psiko-pedagogjik në

aspektin teorik dhe atë praktik, që u mundëson ushtrimin e profesionit të mësuesisë, sipas fushës përkatëse të studentit në formimin e mëparshëm universitar.

KREU II ORGANIZIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Neni 4 Organizimi administrativ

- 4.1. Përgjegjësinë për organizimin e Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike për Ushtrimin e Profesionit të Rregulluar të Mësuesit e ka Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes në UST.

Neni 5 Përgjegjësitë e Departamentit

- 5.1. Departamenti i jep studentëve gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me Rregulloren, politikën e zhvillimit të programit, kriteret e pranimit, planin dhe programet lëndore, rregullat e vlerësimit, rregullat e certifikimit, rregullat financiare.
- 5.2. Respekton të gjitha kriteret profesionale, shkencore dhe pedagogjike për mësimdhënien, praktikën, vlerësimin.
- 5.3. Asiston studentët në plotësimin e kërkesave që lidhen me zbatimin e programit të studimit.
- 5.4. Krijon kushtet e përshtatshme për realizimin e programit (siguron mjediset, rrjetin e informacionit, vë në dispozicion bibliotekën, mjete mësimore dhe teknologjinë elektronike).

Neni 6 Koordinimi dhe këshillimi

- 6.1. Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit, cakton koordinatorin për programin, i cili mban lidhjet me Departamentin dhe Fakultetin, bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet në funksion të realizimit/zhvillimit të programit, si dhe asiston e këshillon studentët në lidhje me studimet.
- 6.2. Staf i akademik i programit, asiston, informon dhe këshillon studentët në lidhje me lëndët përkatëse dhe realizimin e tyre.

Neni 7 Programi i studimit të formimit të vazhduar

Programi i Studimit të Formimit të Vazhduar ofron një formim të specializuar në fushën psiko-pedagogjike dhe drejton studentin drejt specializimit të profesionit të mësuesisë. Ai realizohet me:

- 35 kredite;
- ofrohet me kohë të plotë.

Neni 8 Forma dhe Afati i studimeve

Programi i studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike në “Edukim Fizik, Sport dhe Shëndet” ofrohet me kohë të plotë. Kohëzgjatja normale e studimit për Programin Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike me 35 kredite është 1 (një) semestër të vitit akademik.

Neni 9 Politika e regjistrimit dhe frekuentimit

- 9.1. Në këtë program studimi regjistrohen ata kandidatë që kanë mbaruar studimet universitare konform ankesit 1. të Udhëzimit Nr. 3, datë 15.02.2023 i MAS “Për Përcaktimin e Diplomave Universitare të Njëvlershme, të Ngjashme ose të Përafërta me Fushën/lëndët e Mësimdhënies në Arsimin Parauniversitar dhe Kriteret për Hapjen e Programeve të Studimeve të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike”.
- 9.2. Kanë diplomë të ciklit të dytë Master i Shkencave, Master Profesional me 120 kredite apo ekuivalente me to, të lëshuara nga insitucione të arsimit të lartë, programi i studimit të së cilave përputhet me një nga fushat / lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar të përcaktuar në aneksin 1 të Udhëzimit Nr. 3, datë 15.02.2023 i MAS
- 9.3. Kanë mesataren e maturës shtetëror që lejon studime bachelor në mësuesi, sipas ligjeve në fuqi.
- 9.4. Frekuentimi i studentëve është i detyrueshëm për të gjitha lëndët/modulet mësimore sipas përcaktimeve në programet lëndore dhe aktet rregullatore të UST – së.
- 9.5. Pjesëmarrja në orët mësimore në auditor është e detyrueshme për të marrë kreditet e përcaktuara për lëndët/modulet.
- 9.6. Mosfrekuentimi në procesin mësimor në programin e studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike “Edukim Fizik, Sport dhe Shëndet”, është e pranuar deri në masën 25% të orëve mësimore të parashikuara në auditor.

Neni 10 Frekuentimi nga studentët i veprimtarive akademike

- 10.1. Pedagogët duhet të mbajnë shënime për frekuentimin e studentëve.
- 10.2. Pedagogët duhet të njoftojnë studentët për pasojat e mungesave në vlerësim.
- 10.3. Pedagogu i lëndës/modulit plotëson proces-verbalin me informacionin përkatës për çdo student, lidhur me fitimin e të drejtës për të realizuar provimet lëndore/moduleve, të cilin e dorëzon në Sektorin e Sekretarisë Mësimore, pas përfundimit të procesit mësimor të programeve të lëndës/modulit.

Neni 11 **Struktura e studimeve**

- 11.1. Cikli i studimit: Programi i Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike në “Edukim Fizik, Sport dhe Shëndet”
- 11.2. Emërtimi i Certifikatës:
“Certifikatë”
Programi i Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike në “Edukim Fizik, Sport dhe Shëndet”.
- 11.3. Kohëzgjatja e Programit: 1 (një) Semestër
- 11.4. ECTS total: 35 ECTS
- 11.5. Forma e zhvillimit të programit: Me kohë të plotë

Neni 12 **Plani mësimor**

- 11.1. Plani mësimor përbëhet nga:
 - 5 lëndë mësimore të formimit bazë Psiko-Pedagogjik dhe
 - 1 lëndë opsionale, që përcaktohet nga UST në përputhje me specifikat e këtij Institucioni të Arsimit të Lartë.
 - Provimin përfundimtar.
- 11.2. Plani mësimor ndërtohet me lëndë të formimit të domosdoshëm psiko-pedagogjike, konform orientimeve të Grupi i Punës, ngritur me Urdhërin e MAS me Urdhër Nr.115, datë 27.02.2023. Plani mësimor miratohet me vendim të Senatit të UST-së.

Neni 13 **Programi i lëndës**

Programi i lëndës hartohet dhe nënshkruhet nga titullari i saj, sipas formatit standard të miratuar nga UST dhe konform VKM Nr. 41, datë 22.2.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” dhe pas miratimit, depozitohen në Departament.

Neni 14 **Format e mësimit**

- 14.1. Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike: leksioneve, seminareve, diskutimeve, debatit, punës në grupe, studimit të rastit, simulimeve, prezantimeve, praktikës.
- 14.2. Kohëzgjatja e seancave mësimore është 50 minuta.

14.3. Veprimtaria mësimore e programit zhvillohet në gjuhën shqipe.

KREU III

VLERËSIMI I STUDENTIT

Neni 15

Kritere dhe procedura të vlerësimit

- 15.1. Kriteret dhe format e vlerësimit të studentit përcaktohen në planin mësimor, në programin e lëndës dhe i bëhen të njohura studentëve në fillim të tyre.
- 15.2. Vlerësimi në një lëndë mund të bëhet: a) me provim me shkrim, me gojë ose i kombinuar; b) me detyra kursi, projekte, ese; c) i bazuar në një shumëllojshmëri formash vlerësimi.
- 15.3. Vlerësimi për secilën lëndë mësimore kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në përfundim të saj.
- 15.4. Notat vendosen në bazë të pikëve.
- 15.5. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash.
- 15.6. Vlerësimi kryhet sipas sistemit të detajuar më poshtë:

Nota	ECTS nota	Suksesi pikë - %	Përkufizimi
10	A	91 -100%	SHKËLQYESHËM – njohuri të shkëlqyeshme me vetëm disa gabime minore
9	B+	81 – 90 %	SHUMË MIRË – arritje mbi mesatare, por me disa gabime
8	B	71 – 80 %	MIRË – rezultat në përgjithësi i mirë me disa gabime që vërehen
7	C	61 – 70 %	KËNAQSHËM – mirë, por me mjaftë gabime
6	D	51 – 60 %	MJAFTON – mjaftushem, por me mjaftë gabime
5	E	40 – 50 %	Rezultatet plotësojnë kriteret minimale
4	F	00 – 39 %	DOBËT – kërkohet shumë punë për të fituar kredit.

Neni 16

E drejta për të hyrë në provim

- 16.1. Studenti fiton të drejtën të futet në provimin e një lënde, kur ka shlyer detyrimet që lidhen me atë lëndë, të parashikuara për shlyerje në planin mësimor/programin lëndor dhe kur ka frekuentuar lëndën/modulin në masën e përcaktuar.
- 16.2. Studenti nuk mund të hyjë në të njëjtën ditë në dy provime në lëndë të ndryshme.
- 16.3. Studentët nuk lejohen të hynë në provime lëndore/moduleve gjatë sezonit të rregullt, nëqoftëse nuk kanë shlyer detyrimet përkatëse në UST.

Neni 17

Zhvillimi i provimeve

- 17.1. Provimet zhvillohen në përfundim të kursit, duke përcaktuar një sezon 2 javor për përfundimin e tyre
- 17.2. Provimet dhe riprovimet, detyrat e kursit dhe prezantimet zhvillohen sipas afateve të caktuara në strukturën e vitit akademik.
- 17.3. Në rast pamundësie të jashtëzakonshme të zhvillimit të provimit ose të prezantimit ditën e caktuar, Dekani miraton dhe shpall një datë tjetër të mëvonshme e cila u bëhet e njohur studentëve dhe pedagogëve.
- 17.4. Provimet vlerësohen nga pedagogu/pedagogët që kanë zhvilluar lëndën. Në raste të veçanta Departamenti cakton një komision tjetër.

Neni 18

Riprovimi

- 18.1. Studenti i vlerësuar mbetës në sezonin e rregullt të provimit (Sezon i Dimrit), ka të drejtë të përdorë të gjitha datat e shpallura nga Njësia Kryesore në Sezonin e Vjeshtës.
- 18.2. Studenti nuk konsiderohet përsëritës kur i ka shlyer të gjitha detyrimet akademike të semestrit akademik, të programit të formimit të vazhduar, por nuk ka dhënë provimin përmbyllës.
- 18.3. Riprovimi në një lëndë të caktuar kryhet dy javë pas provimit të dhënë më parë.

Neni 19

Komunikimi i vlerësimeve

- 19.1. Pedagogu u bën me dije studentëve rezultatet e provimit në përfundim të tij brenda 5 ditëve të punës nga data e zhvillimit të tij.
- 19.2. Një kopje të pasqyrës së rezultateve akademike të studentëve, procesverbalin e mban Sekretaria Mësimore.
- 19.3. Studentët informohen mbi rezultatet e provimit pranë Sekretarisë Mësimore.

Neni 20

Dokumentimi i vlerësimeve

- 20.1. Vlerësimet dokumentohen në Procesverbalin e vlerësimit dhe në Regjistrin e rezultateve akademike.
- 20.2. Procesverbali i vlerësimit plotësohet nga pedagogu në përfundim të procesit të vlerësimit dhe dorëzohet në sekretari jo më vonë se 5 ditë nga dita e provimit ose e prezantimit të detyrës së kursit. Procesverbali i vlerësimit firmoset nga komisioni i provimit, Dekani dhe Përgjegjësi i Sektorit të Sekretarisë Mësimore.
- 20.3. Në asnjë rast procesverbali i vlerësimit nuk duhet të ketë korrigjime dhe askush nuk ka të drejtë të shtojë emra në të.

KREU IV

CERTIFIKIMI

Neni 21

Procedura e Certifikimit

- 21.1. Certifikimi i studenti bëhet pasi ai/ajo ka shlyer të gjitha provimet e lëndëve sipas planit mësimor, si dhe provimin përfundimtar.
- 21.2. Certifikata nënshkruhet nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori i UST.

Neni 22

Marrja e certifikatës

Tërheqja e certifikatës bëhet personalisht nga student i certifikuar, kundrejt nënshkrimit dhe evidentohet në regjistrin e diplomave/certifikatave.

KREU V

PRANIMI I STUDENTËVE

Neni 23

Politika dhe kriteret e pranimit

- 23.1. Pranimi i kandidatëve bëhet me aplikim të studentëve. Kandidati aplikues duhet të zotërojë një diplomë të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në fushën e Edukimit Fizik dhe Sportit, konform ankesit 1., të Udhëzimit Nr. 3, datë 15.02.2023 i MAS "Për Përcaktimin e Diplomave Universitare të Njëvlershme, të Ngjashme ose të Përafërta me Fushën/lëndët e Mësimdhënies në Arsimin Parauniversitar dhe Kriteret për Hapjen e Programeve të Studimeve të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike". Aplikantët që kanë përfunduar studimet jashtë vendit, duhet të diploma/diplomat të jenë të njehsuara dhe ekuivalentuara sipas kërkesave të akteve ligjore në fuqi.
- 23.2. Kandidati duhet të ketë edhe Diplomë të ciklit të dytë Master i Shkencave, Master Profesional me 120 kredite, apo ekuivalente me to, të lëshuara nga insitucione të arsimit të lartë, programi i studimit të së cilave është në fushën e Edukimit Fizik dhe Sportit, Aktivitet Fizik dhe Shëndet.

Neni 24

Dokumentacioni i aplikimit

- a) Formulari i plotësuar i kërkesës.
- b) Fotokopje e kartës së identitetit.

- c) Diploma e Maturës Shtetërore, diplomat e studimeve të larta *universtare (Bachelor, Master Shkencore, Diplomë e Studimeve të Integruara)*, sipas kritereve të parashtruara në pikën 8.1 dhe 8.2 të nenit 8 dhe nenit 23 të kësaj Rregulloreje.
- d) Vërtetim të lëshuar nga IAL për konfirmimin e përfundimit nga kandidati/aplikanti të studimeve të ciklit të parë dhe të dytë. Vërtetimi nga IAL duhet të jetë jo më shumë se tre muaj nga afati i aplikimit për pranimit në programin e formimit të vazhduar që ofron UST.
- e) 2 fotografi me format pasaporte.
- f) Fletëpagesa e tarifës së regjistrimit.

Neni 25

Informacioni për kriteret dhe procedurat e pranimit

Informacioni për kriteret dhe procedurat e pranimit publikohet:

- në faqen e Internetit të UST, si dhe media elektronike të tjera të UST-së
- në paketën e informacionit të studimeve vazhduar që ofron UST.

KREU VI

STUDENTËT

Neni 26

Të drejtat e studentëve

Studentët kanë këto të drejta:

- a. Të udhëhiqen nga rregulla dhe procedura të formuluar qartë dhe të justifikuar në aspektin akademik.
- b. Të jenë të mbrojtur nga diskriminimi i çdo lloji ose nga ndonjë kriter i papërshtatshëm i vlerësimit akademik.
- c. Të kenë në dispozicion të gjithë informacionin që u takon të kenë për të gjitha çështjet akademike dhe veprimtarinë e shkollës.
- d. Të përdorin pajisjet e UST, sipas rregullave përkatëse për të realizuar programin mësimor dhe punën e programuar në aktivitetin e tyre shkencor, bibliotekën dhe Internetin;
- e. Të paraqesin pikëpamjet e tyre pa frikë nga ndëshkimi.
- f. Të përfaqësohen në organet drejtuese të UST.
- g. Të refuzojnë të kryejnë detyra që nuk lidhen me zhvillimin profesional.
- h. Të paraqesin cdo pretendim që lidhet me cilësinë e shërbimit arsimor dhe për cdo shkelje apo kufuzim të të drejtave të tyre si studentë.

Neni 27

Përgjegjësitë e studentëve

Studentët kanë këto përgjegjësi:

- a. Të njohin dhe të zbatojnë Rregulloren, kërkesat e programit të studimit dhe të jenë të vetëdijshëm për zbatimin e tyre.
- b. Të sillen në një mënyrë profesionale dhe qytetare në tërë ndërveprimet në institucion me drejtuesit, personelin akademik dhe administrativ, studentët e tjerë dhe bashkëpunëtorët e departamentit.
- c. Të përdorin me përkujdesje logjistikën, bazën materiale, mjetet dhe pajisjet mësimore të disponuara nga institucioni.
- d. Të përmbushin në kohë të gjitha kërkesat dhe detyrimet e programeve lëndore dhe të praktikës.
- e. Të respektojnë kohën e pedagogëve.
- f. Të paguajnë tarifën e regjistrimit dhe tarifën e studimit në afatet e caktuara.
- g. Të mbajnë përgjegjësi për shkeljet e rregullave nga ana e tyre.
- i. Të udhëhiqen nga vlerat konstruktive të etikës, respektit ndaj kolegëve dhe personelit akademik.
- j. Të respektojnë dhe të promovojnë traditën, arritjet dhe reputacionin e krijuar nga UST.


KREU VII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 28

- 28.1. Kjo rregullore mund të përmirësohet, ndryshohet dhe/ose të korrigohet nga Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit. Ndryshimet dhe/ose korrigjimet publikohen në web faqen zyrtare të UST.
- 28.2. Një kopje e kësaj rregulloreje depozitohet në protokollin e UST.
- 28.3. Të drejtën e interpretimit të kësaj Rregulloreje e ka Zyra Juridike e UST.

Tiranë, Mars 2023


UNIVERSITETI SPORTEVE TIRANË
FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES
DEPARTAMENTI I EDUKIMIT DHE SHËNDETIT
PLANI MËSIMOR



Programi i Studimit: Formimi i Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike në
"Edukim Fizik, Sport dhe Shëndet"

Forma e studimit: me kohë të plotë

Viti akademik 2024-2025

Kodi i lëndës	Emërtimi i lëndës/veprimtarisë	Kategoria e lëndës / veprimtarisë	Ngarkesa në kreditë ECTS:				Ngarkesa mësimore në orë fizike auditor		Pedagogu i lëndës/modulit
			Total ECTS	Orë gjithsej	Lëslon	Seminar	Orë praktike	Orë jashtë auditorit	
1	Zhvillimi i Kurrikulës	B	2,5	125	30	30	65	2,2	Dr.D.Sallaku
	a. Kurikula		2,5	62,5	15	15	32,5	1,1	Dr.D.Sallaku
	b. Arsimi Gjithëpërfshirës		2,5	62,5	15	15	32,5	1,1	Dr.B.Aliaj
2	Metodologji e Mesimdhënies dhe të Nxënit	B	7	175	60	30	85	4,2	Dr.D.Sallaku
	a. Metodatat e Mesimdhënies		3	77	26	14	37	2,1	Dr.D.Sallaku
	b. Mendimi Kritik		2	49	17	8	24	2,1	Dr.M.Shelu
	c. Të nxënit		2	49	17	8	24	2,1	Dr.M.Shelu
3	Mësimimi i të Nxënit	B	6	150	30	30	90	2,2	Dr.D.Sallaku
4	Psikologji Zhvillimi dhe Edukimi	A	6	150	60	15	75	4,1	Dr.B.Aliaj
	a. Psikologji Zhvillimi		4	100	40	10	50	4,1	Dr.B.Aliaj
	b. Psikologji Edukimi		2	50	20	5	25	4,1	Dr.B.Aliaj
5	Menaxhimi i Gases	C	3	75	15	15	45	1,1	Dr.M.Shelu
6	Lëndë Opsionale/ Legjislacion dhe Politikat Arsimore	C	3	75	15	15	45	1,1	Dr.D.Sallaku
7	Provim Përfundimtar	E	125						Departamenti
	TOTALI		35	875	210	135	530	23	

Përgjegjësi i Departamentit

Dr.Kejta Ushtelenca

Dekan

Prof.Dr. Shqipëri Prifti





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTVEVE TË TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES

CERTIFIKATË

Ë PROGRAMIT TË FORMIMIT TË VAZHDUAR NË PSIKO – PEDAGOGJI

NË “EDUKIM FIZIK, SPORT DHE SHËNDETË”

I jepet

Z/Znj. _____, lindur në _____, datë _____

(emër, atësia, mbiemri)

(vendi)

(data, muaji, viti)

në përfundim të Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në fushën Psiko – Pedagogjike në “Edukim Fizik, Sport dhe Shëndet”, me kohë të plotë, 1 (një) semestër, 35 kredite (ECTS), niveli i 7-të, referuar Komizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Përfundoi studimet në datë ____ / ____ / ____

Data e lëshimit të certifikatës ____ / ____ / ____

Nr. Regjistri _____

DEKANI

REKTORI

“Kjo certifikatë shqërohet nga lista e notave”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES

LISTA E NOTAVE

Vërtetojmë së Z/Znj. _____, lindur në _____
datë _____, ka kryer Programin e Studimit të Formimit të Vazhduar në fushën Psiko –
Pedagogji në “Edukim Fizik, Sport dhe Shëndet” gjatë periudhës _____.
Bazuar në regjistrin e arritjeve akademike rezulton të këtë dhënë këto lëndë me notë dhe kredite
përkatëse.

Nr.	Emërtimi/Lëndë / Vendi	Notë	Kredite
1	Kurrikula dhe arsimi gjithëpërfshirës		5
	• Kurrikula		2.5
	• Arsimi gjithëpërfshirës		2.5
2	Metodologji e mësimdhënies dhe të nxënit		7
	• Metodat e mesimdhënies		3
	• Mendimi kritik		2
	• Të nxënit		2
3	Vlerësimi i të nxënit		6
4	Psikologji zhvillimi dhe edukimi		6
	• Psikologji zhvillimi		4
	• Psikologji edukimi		2
5	Menaxhimi i klases		3
6	Legjislacioni dhe Politikat Arsimore/Lëndë opsionale		3
7	Provimi Përfundimtar		5
	Total Kredite		35

DEKANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS

PERSONELI AKADEMIKE ME KOHË TË PLOTË

Lista e plotë emërore e personelit akademik me kohë të plotë për programin e studimit: Formimi i Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike në “Edukim Fizik, Sport dhe Shëndet” është 4 sipas listës më poshtë:

Lista e personelit akademike që ofron programin e studimit

Nr.	Personeli akademik	Titulli akademik dhe grada shkencore perkatëse	Institucioni	Njesia/grupi njesive baze	Elona i vazhimit
1	Blerina Aliaj	Dr. Psikologji-Pedagogji	UST	FSHL / Dep. Edukimit dhe Shëndetit	Me kohë të plotë
2	Marsela Shehu	Dr. Pedagogji	UST	FSHL / Dep. Shkencave Soc. dhe Edukimit	Me kohë të plotë
3	Dritan Sallaku	Dr. Pedagogji	UST	FSHL / Dep. Shkencave Soc. dhe Edukimit	Me kohë të plotë
4	Elona Mehmeti	Dr. Shkencat Politike	UST	IKSHS / Dep. Projekteve dhe Teknologjisë	Me kohë të plotë

REKTORI

Prof. Dr. Agron KASA

